



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 22.02.2012, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi,
Kimete Bytyçi, Justina Pula, dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Albana Gashi, Biserka Kostiq dhe Duda Balje.

Pjesëmarrës të tjerë: Florije Mehmeti-KDI; Lejla Selimi – OSBE; Berian Mustafa – RTK; Fetije Dervisholli-praktikante; Rifat Krasniqi-NDI; Talat Zeqaj, Grejkoc-Suharekë; Zeqir Kurtishaj, Grejkoc- Suharekë; Nuredin Ibishi-CDF; Ukë Gashi-ZPRK dhe Burim Tahiri- praktikant.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi, Suazan Novoberdali- kryetare. Ajo konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1 shkurt 2011;
3. Njoftim me punën e grupit të punës rreth amendamentimit të Projektligjit për të verbrit;
4. Shqyrtimi i peticioneve;

5. Caktimi i datave të mbledhjeve të Komisionit lidhur me shqyrtimin e pikave të Planit të veprimt;
- 6 . Të ndryshme.

.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rita Hajzeraj- Propozoi që pika e katërt e rendit të ditës të shqyrtohet në vend të pikës së tretë, për arsye se palët që janë duke pritur për pikën e katërt të mos presin.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1 shkurt 2012

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 01.02.2012.

3. Shqyrtimi i peticioneve

Kryetarja- Theksoi se raportuesit e kanë marrë petitionin dhe e kanë shqyrtuar dhe i ftoi që të marrin fjalën.

Rita Hajzeraj- Theksoi se do t'iu informojmë me përmbajtjen e petitionit të banorëve të fshatit Grejkoc të Komunës së Suharekës dhe se çka mendojmë që të ndërmarrim për fillim, dhe nëse pas ndërmarrjes së këtyre hapave nuk ka qasje pozitive, atëherë si Komision do të shohim rrugë të tjera të zgjidhjes së kontestit pronësor .

Kurtan Kajtazi- Ne e kemi shqyrtuar dhe analizuar petitionin ku tokat e juaja janë marrë në vitin 1953 dhe janë kthyer gjatë vitit 1991, por disa prej tyre nuk janë kthyer në kadastër, disa kanë dokumentacion, ndërsa disa nuk kanë. Banorët kanë shqetësimet e tyre për privatizimin e këtyre tokave dhe është mirë që të shfrytëzohen të gjitha mundësitë tjera, si përmes komunës ashtu edhe përmes institucioneve të tjera, por nuk është kompetencë e Komisionit që të ndalë këtë privatizim, kompetencë e jona është që ta shqyrtojmë këtë petition dhe t'i udhëzojmë sesi të veprohet më tutje.

Zeqir Kurtishaj- Tha se i kam të gjitha dokumentet pronësore, edhe fshatarët kanë dokumente të ngjashme, disave ju mungojnë për shkak se u janë djegur gjatë luftës, kështu që ekziston mundësia që edhe ato t'i sigurojmë. Tani jemi në dijeni se këto prona do të privatizohen nga AKP-ja, në këto toka ka ndodhur ndërrimi i pronarëve, janë shitur e stërshitur pa u definuar dhe është rrezik i madh që të vijë deri te konflikti në mes të fshatarëve.

Kimete Bytyçi- Lidhur me petitionin, theksoi se jam e informuar për këtë problem të qytetarëve të Suharekës. Këta kanë të drejtë ta bëjnë këtë ankesë, sepse pronat janë të tyre. Në këtë aspekt, është mirë që AKP-ja ta ndalojë procesin e privatizimit të këtyre pronave, derisa të shikohet mundësia e zgjidhjes së problemit të këtyre pronave. Problemi është se nëse këtyre fshatarëve iu ka uzurpuar prona dhe vjen dikush nga një komunë tjetër dhe ndërton, atëherë aty mund të lindë problemi E theksoi edhe një herë se

është mirë që AKP-ja ta ndalojë këtë proces, derisa të gjendet zgjidhje për këtë çështje, duke u bazuar në ligj.

Kryetarja- Kemi pasur raste të tilla edhe më herët në Komision. Unë mendoj se janë plotësuar kushtet për të marrë iniciativë si Komision për të ndryshuar Ligjin për privatizimin, sepse ata sipas ligjit e kanë për detyrë që t'i privatizojnë pronat, edhe pse ekziston kontesti gjyqësor dhe kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. Ne si Komision, duhet të inicojmë për ta ndryshuar ligjin, që nëse ka diçka kontestuese AKP-ja, duhet të pritet derisa të kryhet, pra derisa të merret vendim nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pastaj të vazhdojë privatizimi.

Kymete Bajraktari- Duke u ndërlidhur me këtë çështje, tha se janë procedura të cilat marrin kohë, por çka do të ndodhë nëse fillon tenderimi dhe fillon konflikti në mes të fshatarëve, kush është përgjegjës për këto veprime kur këta i kanë informuar të gjitha institucionet kompetente për këtë problem, pra nëse i ndodh diçka, dikujt do t'i bie përgjegjësia për këto ligje të këqija.

Rita Hajzeraj- Duke u ndërlidhur me parafolësit, tha se kush na garanton neve se derisa të bëhet plotësim- ndryshimi i ligjit, i cili kërkon procedurë dhe kohë, nuk do të bëhet privatizimi i këtyre pronave? Unë mendoj se ne si Komision nuk mund të ndërhyjmë në punë të gjykatës, ndërsa e vetmja mundësi është që të bisedohet me kryetarin e Komunës, të kompletohet dokumentacioni dhe t'i dërgohet AKP-së, për ta njoftuar se cilat janë problemet dhe shqetësimet e banorëve dhe të shikohet sesi kanë vepruar komunat tjera me probleme të njëjta dhe mundësinë për të ndaluar procesin e privatizimit.

Justina Pula- Tha se është një problem i ndjeshëm, ju me tërë dokumentacionin që e posedoni duhet të drejtoheni në komunë, në AKP dhe në gjykatë, që të keni si mbulesë se i keni ankesat e juaja dhe keni dokumentacion në rregull, sepse vetëm ato që janë të shkruara në letër mund t'i shtyjnë proceset përpara dhe në mënyrë të vazhdueshme të bëhet presion.

Kurtan Kajtazi- Këto punë për këtë periudhë të pasluftës, është dashur të zgjidhen nga kuvendet komunale, por këto janë neglizhuar dhe ne si shoqëri kemi probleme me bartjen e pronës, kompetente për këtë lëndë është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe asnjë gjykatë tjetër nuk ka të drejtë të merret me këtë lëndë.

Kryetarja- Ne duhet të marrim iniciativë që t'i rekomandojmë Qeverisë për ta sjellë ligjin për plotësim dhe ndryshim, dhe ne si Komision mund ta ngrisim për debat në Kuvend këtë problem dhe për të diskutuar që Ligji për privatizimin nuk është ligj i mirë dhe po krijon probleme, sepse AKP-ja po merr vendim për privatizim pa i pritur vendimet nga gjykatat. Ne këtë e ngrisim si çështje urgjente në Kuvend, të tjera kompetenca si Komision nuk kemi.

Përfundim

Komisioni votoi unanimitisht që të merret iniciativa për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për privatizim dhe të kërkohet debat parlamentar në seancë për privatizimin e pronave nga AKP-ja.

Gjithashtu, t'i drejtohet edhe kryetarit të Komunës për të shqyrtuar këtë, duke u thirrur në të gjitha ato dokumente që ekzistojnë dhe bashkërisht të analizohet dokumentacioni dhe të gjendet mënyra sesi të veprohet tutje.

Rita Hajzeraj- Lidhur me kërkesën e Sindikatës së Pavarur të Kombinatit "Trepça" tha se këta kërkojnë kompensimin e parave që nuk u janë dhënë më herët dhe ne e kemi shqyrtuar dhe konsideroi se nuk është kompetencë e Komisionit, sepse përgjegjëse për këtë kompani është Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Minierave, prandaj ne si Komision duhet të dalim me rekomandim për këtë Ministri.

Komisioni shqyrtoi këtë kërkesë, dhe pas një debati konstruktiv vendosi të nxjerrë këtë

Rekomandim

Komisioni konstatoi se kjo kërkesë nuk bie në kompetencën e Komisionit dhe i rekomandon Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që ta shqyrtojë dhe të marrë vendim lidhur me këtë kërkesë.

4. Njoftim me punën e grupit të punës rreth amendamentimit të Projektligjit për të verbrit

Kryetarja- I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me punën që ka bërë grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër. Ajo tha se dy mbledhjet që i ka pasur grupi i punës, kanë qenë mjaft produktive dhe është bërë një punë e mirë dhe njoftoi se në mbështetje nga UND-ja grupi i punës do të qëndrojë nga data 26-28 shkurt në Gjakovë, në mënyrë që të përfundohet puna rreth amendamentimit të këtij Projektligji.

5. Caktimi i datave të mbledhjeve të Komisionit lidhur me shqyrtimin e pikave të Planit të veprimit

Kryetarja-Tha se, sa i përket caktimit të datave, ajo do të bëhet varësisht prej angazhimeve që do të kemi dhe se si iu konvenon anëtarëve të Komisionit. Dihet se ligjet që do të vijnë në Komision, më shumë do të merremi me monitorime të ligjeve dhe unë besoj se ne do t'i përmbushim me kohë obligimet që janë nga Plani i veprimit, pika që i përket këtij Komisioni.

6 . Të ndryshme

Deputetja, Rita Hajzeraj i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me fillimin e punës për monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit dhe tha se qysh në fillim, vërehet se nuk ka bashkëpunim midis Institucionit të Avokatit të Popullit dhe komunave, përkatësisht

zyrave për të drejtat e njeriut që janë në kuadër të komunave. Ajo tha se ne do të kemi vizita edhe në komuna të tjera, dhe më saktësisht, sesi po respektohet ai ligj dhe si është bashkëpunimi, dhe në fund do të kemi prezent edhe vetë Avokatin e Popullit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu